VENDIM
Nr.367, datë 14.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.21, DATË 7.1.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË KOMITETIT SHTETËROR PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE DHE TË KOMISIONEVE VENDORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "d" të nenit 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

7. Në vendimin nr.21, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 8, lidhja nr.1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 9 vlera "…9000 (nëntë mijë) lekë…" zëvendësohet me vlerën "… 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë…".

c) Shkronja "a" e pikës 13, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Në Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave:

- Këshilltar	90 113 lekë;
- Zëdhënës shtypi	53 199 lekë;
- Sekretar	31 485 lekë.".

ç) Shkronja "b" e pikës 13, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Në komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave:

- Kryetari	59 714 lekë;
- Anëtari	53 199 lekë.".

2. Pika 15 shfuqizohet.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

		PAGA MUJORE

EMËRTIMI	KATEGORITË	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Drejtor drejtorie	II-b	10 050	2%	0	80 342
Përgjegjës sektori në Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të pronave	III-a	10 050	2%	0	59 714
Përgjegjës sektori në Komitetin Shtetëror. Specialist i nivelit të lartë në Komitetin Shtetëror.	III-b	10 050	2%	0	43 428
Specialist i nivelit të mesëm në Komitetin Shtetëror.	IV-a	10 050	2%	0	32 571
Specialist në Komitetin Shtetëror. Specialist në komisionet vendore	IV-b	10 050	2%	0	21 714